



Universiteti i Prishtinës “HASAN PRISHTINA”

Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri

Rr. Eqrem Çabej 111, 10000 Prishtinë

Trajnimi dhe Certifikimi i Auditorëve të Energjisë

Ftohen ekspertët e fushave përkatëse që të aplikojnë në Trajnimin për Auditorë të Energjisë në ndërtesa dhe ndriçim publik i cili organizohet nga Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri e UPHP organizon. Trajnimi planifikohet të mbahet gjatë muajit Shkurt/ Mars 2022.

Trajnimi i Auditorëve të Energjisë do të realizohet sipas Rregullores (MEPTINIS) Nr. 05/2020 Për sistemin e ofruesve të shërbimit energjetik dhe kriteret minimale për auditimin energjetik-e, cila rrjedhë nga Ligji Nr. 06/L-079 Për efikasitet të energjisë

Trajnimi realizohet nga Trajnerët për Auditim të Energjisë të cilët janë të certifikuar nga konzorciumi EIHP (Energy Institute Hrvoje Požar) & FIRE (Federazione Italiana per L'uso Razionale Dell'energia), në vitin 2018.

Bazuar në Shtojcën I të Rregullores (MEPTINIS) Nr. 05/2020, trajnimi përbëhet prej katër pjesëve si vijon:

- Java e parë dhe dytë – Ligjëratat (minimum 40 orë),
- Java e tretë – Vizitat në teren,
- Java e katërt – Përgatitja, dhe Prezantimi i Raportit të auditimit energjetik, dhe
- Java e pestë – Përgatitja për provim, Provimi përfundimtar (150 minuta).

Në fund të trajnimit, gjatë javës së pestë, parashihet testi me shkrim me një kohëzgjatje prej 150 minutash që rrjedh nga materialet e trajnimit të përdorura në programin e trajnimit dhe kandidatët duhet të kenë arritur kalueshmërinë prej së paku 70%.

Sipas Rregullores (MEPTINIS) Nr. 05/2020 Kapitulli III - Kërkesat për kualifikimin dhe certifikimin e auditorëve të energjisë, vlerësuesve të energjisë dhe ekspertëve të pavarur, Neni 5 Auditorët e energjisë, kualifikimi, trajnimi dhe certifikimi i Auditorëve të energjisë. Pika 4. Auditori i Energjisë në Ndërtesa për t'u certifikuar duhet të përmbushë kriteret minimale të përshkruara në vijim.

Kriteret minimale për Auditor të Energjisë:

Kriteret	Pranueshmëria	Shpjegim
----------	---------------	----------

Kualifikimi arsimor / edukimi	Për auditorët e energjisë dhe ndërtesa dhe ndriçim publik: - Arkitektura, ndërtimtaria e lartë, inxhinieri mekanike, inxhinieri elektrike apo fushë ekuivalente të inxhinierisë.	Këto kualifikime arsimore kërkohen zakonisht në kryerjen e auditimeve energjetike dhe sigurojnë njohuri të mëparshme për sistemet teknike dhe instalime që janë subjekt i auditimit energjetik, duke përfshi përvojën e dëshmuar profesionale.
Diploma e kërkuar	Diplomën Master ¹ (së paku 300 pikë të ECTS ²) në Arkitekturë, ndërtimtaria e lartë, inxhinieri mekanike, inxhinieri elektrike apo fushë ekuivalente të inxhinierisë.	Kërkohen 300 ECTS kredi ose ekuivalent sipas programeve të mëparshme arsimore. (p.sh. inxh. i dipl.).
Dokumentimi i përvojës	- Së paku 5 vite përvojë profesionale e verifikueshme në projektim, zbatim dhe mbikëqyrje të projekteve arkitektonike, ndërtimore dhe inxhinierike. - CV, referencat dhe lista e projekteve të dorëzohen.	Të dhënat e dokumentuara dhe kohëzgjatja e përvojës së punës do të demonstrojnë ekzistencën e eksperiencave inxhinierike teorike dhe praktike.

Afati për aplikim për të dy ciklet është prej 25 Janar – 12 Shkurt 2022, ora 16:00.

Numri i kandidatëve/kandidateve për cikël është 28 pjesëmarrës/pjesëmarrëse.

Shpenzimet për trajnim, provimin final dhe Certifikatë do të mbulohen nga kandidatët/kandidatet në shumën prej 460 Euro.

Varësisht nga situata rreth pandemisë COVID-19, do të merret vendimi nëse trajnimi do të mbahet online ose në sallat përkatëse.

Adresa zyrtare për dorëzimin e aplikacioneve është QEQ Prishtinë, vetëm përmes postës elektronike në adresën, xhevat.berisha@uni-pr.edu.

¹ Sipas kornizës ligjore aktuale në Kosovë, profesionistët me diplomë bachelor nuk i plotësojnë kriteret për t'i kryer detyrat e projektantit.

² ECTS – European Credit Accumulation and Transfer System